



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

Agjencia Kadastrale e Kosovës/Katastarska Agencija Kosova/Kosovo Kadastral Agency

Në bazë të neneve 4.7, 29 dhe 34.2 të Ligjit për Kadastrin nr. 04/L-013 i shpallur ne Gazetën Zyrtare nr. 13 me 01.09.2011 , nenit 1.1 , 3.7 të Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr. 2002/5, 2003/13 , Nr. 04/L-009 i shpallur ne Gazetën Zyrtare nr. 7 me dt. 10.08.2011 , Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerr:

**KORNIZË PUNE NR. AKK 2013/02 PËR STANDARDIZIMIN E
MATJEVE DHE RILEVIMEVE KADASTRALE - e plotësuar**

Neni 1.
Qëllimi

1. Korniza e punës Nr.AKK 2013/02 behët për zbatimin e Ligjit për Kadastër dhe Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme dhe për standardizimin e të dhënave që futen në regjistrin zyrtar kadastral.
2. Kornizë e punës Nr.AKK 2013/02 rregullon standardizimin e matjeve dhe rilevimeve kadastrale për krijimin e pronave të paluajtshme.

Neni 2.

Detyrat e ZKK-së për përgaditjen e të dhënave kadastrale

1. Të dhënat që zyrtarët e ZKK-së duhet ti japin gjeodetëve dhe kompanive të licencuara për punë gjeodezike:
 - Koordinatat në xls file si dhe të printuara,
 - Skicën e parcelës në pdf apo jpg dhe të printuar
2. Te gjitha të dhënat e lëshuara nga ZKK duhet të jenë të vulosura dhe të nënshkruara nga personi përgjegjës.
3. Para se të ipen këto të dhëna të lartëcekura duhet të bëhet kontrolli i kualitetit si vijon:
 - 3.1. Duhet të bëhet kontrolli e sipërfaqes në mes të bazës grafike dhe bazës tekstuale (SIKTK),
 - 3.2. Duhet te kontrollohet vektori me planin kadastral (raster), dhe sipas rasteve të bëhen korrigjimet e nevojshme.
 - 3.3. Të kontrollohen planet kadastrale, kjo duhet të bëhet duke insertuar pikat e rendit të I-rë, rendit të II-të, të rendit të III-të, pikat trigonometrike, pikat detale, lidhja e planeve nt mes vete.
4. Të gjitha pikat e lartëcekura duhet evidentohen në listën kontrolluese, dhe kjo liste t'u jepet gjeodetëve dhe kompanive te licencuara për punë gjeodezike, kjo duhet të jetë e vulosur nga zyrtari i ZKK-së.
5. Të gjitha pikat e lartëcekura duhet t'i referohen ligjit për kadastër, udhëzimeve administrative, kornizave të punës si dhe katalogut për matje dhe krijimin e njësive kadastrale.

Neni 3.

Standardet e të dhënave për regjistrim

Të dhënat për regjistrim në bazën zyrtare të të dhënave grafike dhe tekstuale do jenë valide kur plotësohen pikat ne vijim:

1. Dëshmia e burimit të të dhënave zyrtare kadastrale të lëshuar nga ZKK apo AKK,
2. Dëshmia e pagesave për punën kadastrale bazuar në Udhëzim Administrativ në fuqi,
3. Kërkesa për rilevim e parashtruar nga pronari apo i autorizuari,
4. Dorëzimi i fajllit origjinal të matjeve duke i'u referuar kornizës për matje kadastrale dhe katalogut për matje dhe krijimin e njësive kadastrale,
5. Të dhënat për njësitë kadastrale duhet të dorëzohen në njërin format digjital (shapefile, itf, dwg apo gml) dhe të printuara sipas skicës që është bashkangjitur kornizës

6. Letra në të cilën shtypet harta kadastrale për krijim e pronës duhet jetë 120gr/m².

Neni 4

Formati i skicës nga matjet kadastrale

Skica kadastrale e kësaj kornize është dokument zyrtar për arkivim në institucionet e kadastrit. Kësaj kornize i bashkëngjitet edhe forma e skicës për krijimin e njërive kadastrale nga matjet.

Neni 5.

Standardet e matjeve dhe rievimeve kadastrale

Matjet dhe rievimet kadastrale duhet të bëhen sipas standardeve në vijim:

1. Dy rievime për secilën pikë plotësuese të stabilizuar që matet me GNSS rover. Ndryshimi kohor i matjes së parë me të dytën të jetë jo më pak se 35 minuta. Në fund të rievimit bëhet kontrollimi duke marrë leximin në pikën e kontrollit.
2. Një rievim i një pike kontrolluese në largësi nga detaji deri në 5km, për matje me GNSS rover. Rievimi i pikës kontrolluese mund të bëhet para, gjatë ose pas rievimit.
3. Matja me stacion total bëhet duke shfrytëzuar tri pika fikse. Një pikë stacionimi dhe dy pika orientuese. Pika fikse nga e cilat matet apo rievohet dhe pikat orientuese duhet të janë nga baza gjeodezike ose të vendosura si pika plotësuese të matura me GNSS-KOPOS. Matja e pikave të kufijve të parcelave bëhet në dy seri. Në fund të rievimit nga stacioni i njëjtë bëhet rievimi në pikat orientuese.
4. Fajlli origjinal i matjeve të terrenit për pikat e kontrollit dhe për pikat e detajit arkivohet.

Neni 6.

Devijimi standard i matjeve dhe rievimeve kadastrale

Njësia për përcaktimin e saktësisë së matjeve gjeodezike është devijimi standard (σ) i cili zbatohet edhe në matjet dhe rievimet kadastrale. Saktësia e koordinatave për pikat e kontrollit të rendit të parë dhe për stacionet e përhershme të referencës KOPOS është e specifikuar me devijim standard (σ) për kategoritë e terrenit si në tabelën në vijim:

Kategoria	Devijimi standard (σ) në rrafshin horizontal	Përshkrimi
1	Koordinatat trajtohen "pa gabime"	pikë referente e rendit të parë dhe stacionet e përhershme të referencës KOPOS

2	$\sigma \leq 15 \text{ mm}$	pikë referente e rendit të dytë
3	$\sigma \leq 20 \text{ mm}$	pikë referente e rendit të tretë
4	$\sigma \leq 25 \text{ mm}$	pikë plotësuese e stabilizuar për vazhdim të matjeve detaje.
5	$\sigma \leq 30 \text{ mm}$	pikë detaje e njësisë kadastrale në zonën urbane
6	$\sigma \leq 50 \text{ mm}$	pikë detaje e njësisë kadastrale në zonën rurale
7	$\sigma \leq 100 \text{ mm}$	pikë detaje e njësisë kadastrale të rajoneve malore

Neni 7

Gabimi i lejuar (Δ) për matjet dhe rilevimet kadastrale është aprovuar sipas formulës për devijimin standard (σ):

$$\Delta = \pm 2 \sigma$$

Neni 8

Dorëzimi final i të dhënave për futje në regjistrin zyrtar kadastral

Të dhënat për futje në regjistrin zyrtar kadastral, duhet dorëzuar në kopje analoge dhe digjitale me përmbajtje sipas nenit 2. të kësaj kornize.

Neni 9

Verifikimi

Të dhënat e dorëzuara duhet të kontrollohen në ZKK ose AKK, verifikohen dhe pastaj merret vendimi nga zyrtaret përgjegjës, para se të futen në regjistrin zyrtar kadastral.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

Korniza pune hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Prishtinë, me 13.02.2014.

Kryeshefi Ekzekutiv i AKK

Prof. Dr. Murat Meha

